



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-15506/25 datë:04.07.2025



Npi – 01/246 datë: 09.07.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 09.07.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 09.07.2025 (e mërkurë) në ora 15:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, z.Artan Lubovci, znj.Rrezartë Ramadani, dhe z.Arton Demiri, znj.Arjeta Maliqi, znj.Sabrie Veliu. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim, praktikantët znj.Havë Llugaxhiu dhe z.Albion Shabani. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 7 anëtarëve prezent, për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 26.06.2025.
2. Raport i punës për gjashtë mujorin e parë 2025 të KPK-së,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-së më 26.06.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 26.06.2025.**

Pika 2

Raport i punës për gjashtë mujorin e parë 2025 të KPK-së

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Objektivat e KPK-së gati të gjitha janë realizuar, siç janë avokimi, realizimi i buxhetit etj. Në kuadër të sfidave, kemi pas disa mungesa në mbledhjet e KPK-së, pastaj edhe sa i përket vizitave që i kemi pas të planifikuara nuk kemi mujt me i realizuar në tërësi. Mirëpo kemi bërë një punë të mirë në adresimin e çështjeve me rekomandimet që i kemi nxjerrë. E falënderoj z.Idajet Rexhepin zyrtar i Kuvendit, për hartimin e raportit të mbledhjeve për këtë 6

mujor të vitit 2025. Në vazhdim Kryesuesi lexoi raportin e mbledhjeve dhe i komentoi atë për secilën pikë veq e veq (shih dokumentin). Punën e Komitetit e ka lehtësuar edhe pranimi i z.Muhamet Mehmetit, si zyrtar në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, i cili më parë ishte anëtarë i KPK-së. Tani ky po na sjellë informatat e duhura në Komitet. E falënderoj z.Kadri Eminin anëtar i KPK-së dhe drejtorin e DBF-së z.Besnik Ahmeti që e kanë bërë zgjidhjen për sa i përket pagesave për anëtarët e Komitetit për Komunitete këtu në komunën e Shtimes edhe pse kjo ndalesë e pagesave ka ndodhur në disa Komuna të Kosovës që ka qenë si rrjedhojë e qasjes nga niveli qendror. Një kohë kemi pas edhe një sfidë për sa i përket mungesës së 3 anëtarëve të Komitetit për Komunitete të cilët kanë dhënë dorheqje vullnetarisht për arsyet e tyre personale, por tani e kemi plotësuar Komitetin për Komunitete me të gjithë anëtarët. Hapi diskutimin.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Mbledhjet e Komitetit për Komunitete po e humbin rëndësinë kur mbahen pas mbledhjes së Kuvendit Komunal. Besoj se nuk do të ndodhë në të ardhmen. Sfidë ka qenë mungesa e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, mungesa e zyrtarit të ZKKK-së por edhe mungesa e drejtorëve në mbledhjet e Komitetit për Komunitete. Ne jemi munduar me bërë maksimumin për një punë më të mirë të mundëshme. Duke pas parasysh rekomandimet që i kemi miratuar besoj se ne mund të dalim më të fuqishmit. Jamë krenar që jamë në këtë Komitet dhe do të jem deri në fund.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Unë e kamë shikuar ftesën e Kuvendit dhe e kamë parë se nuk ka pasë ndonjë pikë të rëndësishme. Disa çështje që i përmende Besnik i vlerësoj, sepse unë i harrova. Mungesa e drejtorëve është në njëfarë mesazhi as shumë keq e as shumë mirë. Disa rekomandime janë marrë parasysh.

z.Arton Demiri: Përshëndetje, deshta me të plotësuar Kryesues kur the që nuk kemi pas vizita. Unë kam qenë jo bashkarisht mirëpo veqmas kam bërë disa vizita, psh. kamë qenë te familjet Jakupi te rruga e re dhe e kamë vërejtë se kanë nevojë mjaftë shumë për ndihma.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi raportin e punës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025 të Komitetit për Komunitete.**

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë. Nëse nuk ka diskutime atëherë ju dëshirojë pushime të këndshme verore. Shihemi në fund të muajit Gusht.

Pasi që diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:32h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

